



Posta e Kosovës SH.A.  
28 Nëntori Nr.4 10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës  
www.postakosoves.com

Nr. 01-721/24  
Datë 21-03-2024  
Prishtinë

Në mbështetje të Raportit zyrtar të Inspektoratit të Punës me nr: 01Nr.25-62/2024,RZ01Nr.25-55/2024,RZ01Nr.09-32/2024,RZ01Nr.25-47/2024 dhe vendimit nr 01Nr.25-35/2024, në bazë të Rregullores për rregullimin e marrëdhënies së punës me numër 01-2710/2021, dt. 09.11.2021, Kryeshefja Ekzekutive e PK Sh.A. më datën 20.03.2024 bie këtë:

#### V E N D I M

**Mbi zbatimin dhe plotësimin e raporteve dhe vendimit të Inspektoratit të Punës për konkursin me nr. 01-2592/23 të dt.02.11.2023 për pozitën sportelistë**

- I. Anulohet Vendimi nr.01-125/24 dt.17.01.2024, mbi përzgjedhjen e kandidateve me te suksesshëm sipas listës definitive, sipas konkursit nr.01-2592/23 dt.02.11.2023, per pozitën e punës; Sportelist.
- II. Bazuar raportit zyrtar të Inspektoratit të punës me nr RZ 01Nr.25-62/2024,RZ 01Nr.25-55/2024,RZ 01/09-32/2024, RZ01Nr.25-47/2024 si dhe vendimit me 01Nr .25-35/2024,merret ky vendim për rikthimin e procesit të konkursit me nr 01-2592/2023 në procesin e intervistes me gojë sipas vërejtjeve të IP-së i cili është i bazuar ne nenin 11, paragrafet 5 dhe 8 të UA 07/2017.
- III. Komisioni është i obliguar të ftojë në afatin optimal të gjithë kandidatët në intervistën me gojë të cilët paraprakisht kanë kaluar pragun e testit me shkrim sikurse kane qene të njoftuar me rezultatin e testit me shkrim .
- IV. Komisioni gjate punës se tij duhet të evitoj dhe te ketë parasysh të gjitha vërejtjet e Inspektoratit të punës sipas raporteve te cituara me sipër dhe të respektoj në përpikëri dispozitat e UA 07/2017.
- V. Pas intervistimit me gojë komisioni përzgjedhës konform dispozitave te UA 07/2017 do të përpiloje procesverbalin dhe vendimin për përzgjedhjen e kandidateve më të suksesshëm, dhe për të cilën do ti njoftojë kandidatet sipas dispozitave te UA 07/2017.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### A R S Y E T I M

I. Me qëllim të respektimit dhe plotësimit të vërejtjeve të IP-s , Kryeshefja Ekzekutive e PK-s ka marr këtë vendim duke u mbështetur në raportet dhe vendimet e Inspektoratit të punës si dhe pas konsultave verbale të Postës së Kosovës dhe Kryeinspektorit të IP-s lidhur me zbatimin e raporteve dhe vendimit të IP-s(nr RZ 01Nr.25-62/2024,RZ 01Nr.25-55/2024,RZ 01/09-32/2024, RZ01Nr.25-47/2024 si dhe vendimit me 01Nr .25-35/2024) për konkursin me nr 01-2592/2023, me të cilin ka rikthyer procesin deri në fazën e intervistimit me gojë, duke anuluar veprimet e ndërmarra më herët në ketë fazë e tutje. Andaj konkursi do të vazhdojë nga faza e intervistimit me gojë deri në përmbylljen dhe përzgjedhjen e kandidateve sipas konkursit.

Me sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij Vendimi, Aplikantët kan të drejtë ANKESE që brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqet ankesë te Gjykata Themelore në Prishtinë .

T'i dorëzohet:

- 1x KE
- 1x RNJ të PK Sh.A.
- 1x Arkivit të PK Sh.A.
- 1x Komisionit Perzgjedhës
- 1X Inspektoriatit të Punës

Nora Rraci

Kryeshefe Ekzekutive e PK Sh.A.

